



në SHQIPËRI



Përmes bashkëpunimit teknik dhe projekteve të kredisë së ndihmës për zhvillim, JICA ofron mbështetje për Shqipërinë në fushat e mbrojtjes së mjedisit dhe planifikimit urban.

PROJEKTI I PËRMIRËSIMIT TË SISTEMIT TË KANALIZIMEVE TË TIRANËS SË MADHE

Skema: **Kredi në jене**
U/Z: **Qershor 2008**
Organizatrat partnere: **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e ujësjellës-kanalizimeve dhe infrastrukturës së mbetjeve**

Zona e Tiranës së Madhe po zhvillohet me shpejtësi, e nxitur nga përqendrimi i kapitalit në Shqipëri dhe investimeve të huaja. Pavarësisht rritjes së sasisë të ujërave të ndotura industriale dhe shtëpiake, sistemi i ujërave të ndotura mbetet i pazhvilluar, kështu që lumi Lana, i cili rrjedh nëpër qytetin e Tiranës dhe rrethinat, është ndotur seriozisht nga shkarkimi i drejtpërdrejtë i ujërave të ndotura të patrajuara dhe hedhjes së mbeturinave. Si rezultat, mbeturinat e akumuluar dhe era e keqe ndikojnë negativisht në higjienën dhe mjedisin ku jetojnë banorët e qytetit. Meqenëse një numër i madh i njerëzve mbështeten në pusët për ujë të pijshëm në zonën e rrjedhës së poshtme të Lanës, ekziston një shqetësim për ndotjen e ujërave nëntokësore, që mund të shkaktohet nga ujrave të ndotura. Me mbështetjen e Agjencisë Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar, JICA, pritet përmirësimi i cilësisë së ujërave nëntokësore dhe atyre lumore, përmes ndërtimit të impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura (Trajtimi i ujërave të ndotura, tubacione kanalizimi e kullimi) në zonën e Tiranës së Madhe.




Ndërtimi i impianteve për filtrimin e ujërave të zeza

PROJEKTI PËR INFORMACIONIN GJEOPAPËSINOR DHE ZHVILLIMIN E QËNDRUESHËM TË TOKËS NË ZONËN TIRANË-DURRËS

Skema: **Bashkëpunim Teknik**
Periudha e projektit: **Qershor 2017 - Qershor 2020**
Organizata partnere: **Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG)**

Rajoni Tiranë-Durrës, zona që lidh kryeqytetin Tiranën me Durrësin dhe periferitë, ka përjetuar rritje të popullsisë dhe zhvillim urban në dekadën e fundit. Sidoqoftë, harta zyrtare për rajonin nuk është përditësuar që nga vitet 1980, për shkak të mungesës së kapaciteteve financiare dhe teknike.

Për të reaguar ndaj kësaj situatë, Qeveria e Shqipërisë ka themeluar Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG). Përmes mbështetjes së JICA, ASIG do të zbatojë operacione të integruara në lidhje me informacionin gjeografik me qëllim ndërtimin e infrastrukturës Kombëtare të të dhënave hapësinore (NSDI), si dhe rritjen e kapaciteteve për prodhimin e hartave topografike.



Studentët e Universitet Politeknik në Tiranë duke mësuar se si të krijojnë harta topografike dixhitale

PROJEKTI I PËRFSHIRJES FINANCIARE TË FAMILJEVE TË VOGLA NË SHQIPËRI

Skema: **Bashkëpunim Teknik**
Periudha e projektit: **Nëntor 2017 - Tetor 2021**
Organizatrat partnere: **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**

Ekonomia e Shqipërisë është e bazuar në një segment të madh, tek ekonomitë e vogla dhe sipërmarrja familjare. Dyzet e pesë përqind e popullsisë së saj jeton në zonat rurale. Sektori i bujqësisë ka një nga kontributet më të mëdha në PBB. Nga ana tjetër, vëllimi i përfshirjes financiare në Shqipëri është i ulët. Vetëm 38% e njerëzve mbi 15 vjet kanë llogari bankare në institucionet formale financiare, gjë që lë shumë familje pa qasje në shërbimet financiare. Për të adresuar këtë çështje, JICA dhe Qeveria Shqiptare kanë ndërmarrë këtë projekt. Projekti ka për qëllim të përmirësojë aksesin financiar të fermerëve të vegjël përmes FED Invest, agjencisë që zbaton projektin.



Përdoruesit e projektit

PROJEKTI I PËRMIRËSIMIT TË PAJISJEVE MJEKËSORE TË QENDRAVE RAJONALE TË URGJENCËS

Skema: **Grante dhe bashkëpunimi shoqërues**
B/S (Grant): **Shkurt 2010.**
M/M Bashkëpunimi ndjekës: **Tetor 2015**
Organizatrat partnere: **Ministria e Shëndetësisë**

JICA ka dhënë grante ndihmëse përmes granteve për pajisje mjekësore për Spitalin Pediatric të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në vitin 2000 dhe 2010, me qëllim të modernizimit të pajisjeve mjekësore dhe përmirësimin e shërbimeve mjekësore të këtij spitali. Për të rritur efikasitetin dhe përmirësuar jetëgjatësinë e pajisjeve mjekësore të prokuruarra në kuadër të projektit, është implementuar skema e bashkëpunimit ndjekës të JICA në vlerë

prej 570,000 USD. Qëllimi kryesor i këtij projekti është mirëmbajtja e diagnostikimit dhe trajtimit të shpejtë në spitalin Pediatric për foshnje dhe fëmijë. Pajisje mjekësore të reja, të tilla si radiografia dhe fluoroskopia me reze X, imazheri me ultratinguj, monitorët e pacientëve, nebulizatorët, aspiratorë, si dhe pjesët këmbimi u janë dorëzuar Klinikës së Pediatricës të Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" gjatë vitit 2016-2017.



Klinika e Pediatricës e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" në Tiranë

RRETH JICA

Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Japan International Cooperation Agency - JICA) ndihmon dhe mbështet vendet në zhvillim si agjenci zbatuese për ndihmën Zyrtare për zhvillim të Japonisë (ODA).

Në përputhje me vizionin e saj për të „udhëhequr botën me besim“, JICA mbështet zgjidhjen e çështjeve të vendeve në zhvillim dhe tranzicion duke përdorur mjetet më të përshtatshme të metodave të ndryshme ndihmëse dhe një qasje të kombinuar, të orientuar në rajon, vend dhe probleme.

JICA është e ngarkuar për administrimin e të gjitha ODA-ve, të tilla si bashkëpunimi teknik, bashkëpunimi financiar dhe investicional dhe grante në mënyrë të integruar, përveç kontributeve në organizatat ndërkombëtare. JICA, agjencia më e madhe në botë për ndihmë bilaterale, operon në mbi 150 vende dhe rajone dhe ka rreth 90 zyra jashtë vendit.

Technical Cooperation

Për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe formulimin e sistemeve administrative në vendet në zhvillim, bashkëpunimi teknik përfshin dërgimin e ekspertëve, sigurimin e pajisjeve të nevojshme dhe trajnimin e stafit nga vendet në zhvillim në Japoni dhe vende të tjera. Planet e bashkëpunimit mund të përshtaten sipas gamës së gjerë çështjesh.



Projekti i përfshirjes financiare të familjeve të vogla në Shqipëri



Projekti për informacionin gjeohapësinor dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tokës në zonën Tiranë-Durrës



Trajnimiti në Japoni: Zhvillimi i kapaciteteve në turizmin e qëndrueshëm të bazuar në traditën japoneze "Omotenashi - mikpritje"

Bashkëpunimi financiar dhe investicional

KREDI ODA

Kreditë ODA mbështesin vendet në zhvillim përmes financimit afatgjatë dhe mjeteve financiare koncesionale me interes të ulët. Kreditë ODA përdoren për infrastrukturë të proporcioneve të mëdha dhe forma të tjera të zhvillimit për të cilat nevojiten mjete të konsiderueshme.



Projekti i Përmirësimit të sistemit të kanalizimeve të Tiranës së Madhe

FINANCIIMI I INVESTITIVËVE NË SEKTORIN PRIVAT

JICA mbështet përsheptimin e rritjes ekonomike / sociale të vendeve në zhvillim nëpërmjet sektorit privat, përmes investimeve në borxhe dhe kapital për projektet e zhvillimit të ndërmarrjeve private.

Grantet

Grantet janë burime financiare që i ipën vendeve në zhvillim të cilat kanë të ardhura të ulëta, pa detyrim shlyerje. Grantet përdoren për të përmirësuar infrastrukturën themelore siç janë shkollat, spitalet, hidraulikët dhe rrugët, si dhe për marrjen e kujdesit shëndetësor dhe mjekësor, furnizimin me pajisje dhe kërkesa të tjera.



Klinika Pediatrike e Qendrës Spitalore Universitare "Nënë Tereza" nga Tirana

Ndihmë në katastrofa

Hulumtime

Bashkëpunimi përmes pjesëmarrjes së qytetarëve



RRETH ZYRËS SË BALLKANIT TË JICA

E themeluar në vitin 2006 në Beograd, Serbi, Zyra për Ballkan e agjencisë JICA mbulon Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën*, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi dhe Serbinë. Zyra për Ballkan e agjencisë JICA ofron ndihmë për rritje dhe stabilitet për vendet në rajon, duke punuar kryesisht në fushat e mbrojtjes së mjedisit jetësor, zhvillimit të sektorit privat dhe konsolidimit të paqes.

*Qeveria Japoneze e ka njohur Kosovën si shtet të pavarur më 18 mars, 2008.

Përditësimi i fundit: Dhjetor 2019

ZYRA E BALLKANIT E AGJENCISË JAPONEZE PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR

Qendra e biznesit USCE,
kati 17. Bulevardi Mihajla Pupina 6, 11070 Beograd, Serbi
TEL: +381-(0)11-2200-750

FAKS: +381-(0)11-2200-761
www.jica.go.jp/balkan/english/office/index.html
Facebook: www.facebook.com/jicabalkanoffice/

